

LEDIA DUSHKU

**PËRPPJEKJET E POLITIKËS GREKE PËR ANEKSIMIN
E SHQIPËRISË SË JUGUT: NGA DIPLOMACIA
NË VEPRIME TË ARMATOSURA
(shtator 1913 - shkurt 1914)**

**Komisioni Ndërkombëtar i Kufijve
Jugorë dhe diplomacia greke**

Më 11 gusht 1913, Konferenca e Ambasadorëve e mbledhur në Londër që në dhjetor të një viti më parë, krahas përcaktimit në vija të përgjithshme të kufirit jugor të shtetit shqiptar, vendosi krijimin e dy Komisioneve Ndërkombëtare për caktimin në terren të kufijve veriorë dhe jugorë të tij. Fuqitë e Mëdha përcaktuan në mënyrë të përgjithshme proceduarat e punës së Komisioneve dhe kompetencat e tyre në caktimin e kufirit tokësor. Komisioni i kufirit të Jugut kishte liri veprimi në zonën e Gjirokastrës, fati i së cilës do të vendosej gjatë caktimit në terren të kufirit shqiptaro-grek, ndërsa ishte vendosur që Korça, të ishte pjesë e shtetit shqiptar. Baza ku do të mbështetej puna e tij ishte parimi i përzier “etniko-geografik” dhe në mënyrë të veçantë, elementi i gjuhës së folur në familje. Komisioni duhej të fillonte nga puna më 1 shtator 1913 dhe të përfundonte më 30 nëntor të po atij viti. Tërheqja e ushtrisë greke nga territoret shqiptarë¹ do të fillonte një muaj pasi Komisioni të kishte përcaktuar në terren vijën kufitare shqiptaro-greke.

Më 12 gusht 1913 Konferenca e Ambasadorëve mbylli punimet. Menjëherë Fuqitë e Mëdha u vunë në lëvizje për të bindur qeverinë greke t’i nënshtrohej vendimeve të 11 gushtit 1913 dhe të mbështeste punën e Komisionit Ndërkombëtar të caktimit të kufirit shqiptaro-grek. Pavarësisht përpjekjeve të ndërkombëtarëve, qëndrimi i qeverisë greke

¹ Në kuadrin e Luftës së Parë Ballkanike ushtria greke kishte pushtuar territoret e pretenduara të Shqipërisë së Jugut, në jug të vijës Himarë-Korçë. Për më shumë në lidhje me fazat e pushtimit dhe politikën greke në zonat e pushtuara shih: Ledia Dushku, “Zona e pushtuar nga Greqia dhe përcaktimi i kufirit shqiptaro-grek në Konferencën e Ambasadorëve në Londër (mars-gusht 1913)”, *Studime historike*, Nr. 3-4, 2009, f. 27-44.

vazhdoi të mos njihete tërheqje. Ajo deklaroi se nuk pranonte të lironte vullnetarisht territoret që i ishin dhënë Shqipërisë nga Konferenca e Londrës² dhe se trupat greke në Shqipërinë e Jugut, në rast nevoje, kishin urdhër t'u kundërviheshin vendimeve të Fuqive të Mëdha³.

Qëndrim sfidues ndaj vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve mbajti edhe mbreti i Greqisë, Kostandini. Deklarata e tij se “uniteti i Fuqive të Mëdha në marrjen e një vendimi nuk ishte i njëjtë me unitetin në zbatimin e tij”, shprehnin qartë qëllimin e politikës greke për të vonuar dhe penguar punën e Komisionit. Vonesa e punës së Komisionit i shkante për shtat asaj. Ajo sillte shtyrjen e tërheqjes së ushtrisë greke duke i dhënë kohë përgatitjes së “reagimit të popullsisë vendase”, reagim të cilin Greqia do ta përdorte si mjet presioni ndaj Fuqive të Mëdha, për të përfituar në çështjen e ishujve të Egjeut⁴. Si një oficer i përgatitur në Gjermani dhe kunat i kajzerit Vilhem (Wilhelm), Mbreti u treguar aktiv për të ndryshuar kursin e politikës së jashtme të Greqisë, duke dëshiruar afrimin me fuqitë e Evropës Qendrore: Gjermaninë dhe Austro-Hungarinë⁵. Veçanërisht afrimi me Gjermaninë i shërbente neutralizimit të aksionit diplomatik italian. Në shtator të vitit 1913, mbreti Kostandin vizitoi Berlinin. Në takimet diplomatike ai kundërshtoi bashkimin e qytetit të Korçës me Shqipërinë dhe u përpoq të bindte autoritetet e larta gjermane mbi vështirësitë e zbatimit në terren të vendimeve të Konferencës së Londrës. Ndryshe nga sa ai priste, sekretari gjerman i shtetit i deklaroi me vendosmëri se “një qëndrim i palëkundur i Greqisë në çështjen e kufirit me Shqipërinë nuk i shërben asaj për të fituar dashamirësinë e Trepalëshit. Korça i ishte caktuar Shqipërisë nga të

² *Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv, Albanien* (më tej: *HHSt.A.P.A.A*) në *Arkivin e Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), Vj. 23-9-937, Raport i delegatit të Austro-Hungarisë në Komisionin e Kufirit për Ministrinë e Jashtme, Korfuz: 17 shtator 1913.

³ Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare*, Tiranë: “Albin”, 2003, f. 164.

⁴ Michael Llewellyn Smith, “Venizelo’s diplomacy, 1910-1913” në: *Eleftheros Venizelos: The trials of Statesmanship*, përgatitur për botim nga Paskalis Kitromilides, Universiteti i Edinburgut, 2006, f. 150.

⁵ Thanos Veremis, Helen Gardikas-Katsiadakis, “Protagonist in politics, 1912-1920” në *Eleftheros Venizelos: The trials...* f. 116.

gjitha Fuqitë e Mëdha, për pasojë Greqia duhet të heqë dorë nga pikëpamja intransigjente, të cilës i përmbahet”⁶.

Mesazhe të njëjta mori edhe kryeministri në takimet që zhvilloi me nëpunësit e lartë të politikës britanike. Në notën e 4 shtatorit 1913, qeveria britanike i kërkoi homologes së saj greke “të hiqte dorë prej kundërshtimit të vendimeve të aeropagut evropian”⁷. Qëndrimi britanik ndikoi edhe në atë francez. Shumë shpejt ministri francez në Athinë i deklaroi qeverisë greke, të njëjtën pikëpamje⁸. Më i ashpër ishte qëndrimi i Austro-Hungarisë dhe Italisë. Në notat e tetorit të 1913, që Vjena dhe Roma i drejtuan Athinës, bënin me dije se qeveritë e tyre mbështesnin vendimet e Londrës në lidhje me qëndrueshmërinë e Komisionit dhe evakuimin e ushtrisë greke prej territoreve shqiptare. “Çdo ndryshim, qoftë edhe i përligjur me argumente serioze të rendit lokal, rrezikon të shkaktojë ndërlikime të mëdha të rendit të përgjithshëm. Edhe nëse vullneti i popullsisë do të jetë i sinqertë, ai nuk do të merret parasysh”⁹.

Nga kancelaritë ndërkombëtare tek zonat e pushtuara

Qëndrimi i Fuqive të Mëdha e përqendroi vëmendjen e politikës greke në terren, tek zonat e pushtuara në Shqipërinë e Jugut. Masat e marra aty kishin qëllime të njëjta sikurse edhe diplomacia: të kundërshtonin lënien e Korçës me Shqipërinë, të vononin e të pengonin punën e Komisionit të Kontrollit, t’i paraqisnin zonat ku do të kalonte Komisioni si territore të banuara në shumicë nga popullsi greke, me

⁶ *HHSStA.PA.A* në *AIH*, Vj. 23-34-3453, 23-34-3452, Raport i ministrit të Austro-Hungarisë në Berlin për ministrin e Jashtëm, Bertold, Berlin 9 dhe 12 shtator 1913. Mbi takimin e mbretit të Greqisë me sekretarin e shtetit dhe kajzerin gjerman.

⁷ *British documents on the Origins of the War, 1898-1914*, Vol 10, Pjesa II, London: G.P. Gooch and H. Temperley, 1926-1930, Notë e Ambasadës së Britanisë së Madhe në Athinë për qeverinë greke, Athinë: 4 shtator 1913.

⁸ *HHSStA.PA.A.* në *AIH*, Vj. 23-5-569, Raport i ministrit austro-hungarez në Athinë për Ministrinë e Jashtëme, Athinë, 4 tetor 1913.

⁹ *Ministere des Affaires Etrangères, Archives Diplomatiques* (më tej: *AMAE*) në *AIH*, F. 87, fl. 391-392. Njoftim mbi notën italiane i ministrit të Jashtëm francez për ministrat në Londër, Berlin, Romë, Vjenë, Kostandinopojë, Shën Petërsburg, Athinë, Paris, 12 tetor 1913.

shpresë se në këtë mënyrë Greqia do t'i mbante të okupuara territoret e pushtuara dhe do të asgjësonte vendimet e Londrës për Shqipërinë¹⁰.

Në kohën e përcaktimit në terren të kufirit shqiptaro-grek (shtator-dhjetor 1913) në territoret e pushtuara në Shqipërinë e Jugut u intensifikuan masat me karakter propagandistik. Autoritetet greke të pushtimit qenë në përpjekje të vazhdueshme për të bindur parinë vendase që me anë telegramesh t'i shfaqte Fuqive të Mëdha dëshirën e saj për bashkim me Greqinë¹¹. Fuqive të Mëdha dhe Komisionit të Kufirit të Jugut iu dërguan telegrame ku kundërshtojem emërimi i delegatëve austriakë dhe italianë, të cilët konsideroheshin prej telegram nënshkruesve si të anshëm¹². Një delegacion nga Korça dhe zonat e diskutueshme vizitoi Athinën. Në përbërje të tij ishin edhe mitropolitët e Janinës, Paramithisë, Prevezës dhe Gjirokastrës. Ata u paraqitën si delegatë të zgjedhur prej popullsisë së Shqipërisë së Jugut, të cilët i kërkonin qeverisë greke dhe legatave të Fuqive të Mëdha në Athinë, të anulonin nisjen e Komisionit të Kufirit, me pretekstin se popullsia nuk kishte për ta pranuar atë dhe mund të reagojë në mënyrë të papëlqyer¹³.

Në prag të mbërritjes së Komisionit të Kufirit Jugor, në Janinë u formua një komitet nën kryesinë e mitropolitit grek të Konicës. Anëtarët e tij ishin kryesisht propagandistë grekë, që zotëronin gjuhë të huaja. Komiteti i vuri vetes për detyrë të shoqëronte Komisionin e Kufijve, t'i jepte atij informata në mbështetje të pikëpamjeve greke dhe të detyronte popullsinë shqiptare ortodokse të deklarohej si greke para anëtarëve të tij. Puna e Komitetit u mbështet nga autoritetet ushtarake greke, të cilët bënë përpjekje për të falsifikuar gjendjen reale të popullsisë shqiptare në zonat e kontestuara¹⁴. Një numër i madh familjesh shqiptare u nxorën jashtë nga shtëpitë e tyre dhe në to u strehuan ushtarë dhe banorë me ndjenja greke, të ardhur nga Zagoria dhe Konica. Popullsia vendase, e cila arriti të qëndronte në shtëpi u porosit që në kohën e ardhjes së Komisionit të

¹⁰ *AIH*, A-VI-39, V. 1913-1914, fl. 49, Telegram i ministrit të Britanisë së Madhe në Romë për Ministrinë e Jashtme, Romë: 30 tetor 1913.

¹¹ *HHSIA.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 23-14-1473. Raport i anëtarit austro-hungarez në Komisionin e Kufirit Jugor për Ministrinë e Jashtme, Leskovik: 30 nëntor 1913; *AIH*, A-IV-206, f.13.

¹² Basil Papadakis, *Histoire diplomatique de la question Nord-Epirote (1912-1957)*, Athenes: Imprimerie J. Alevropoulos, 1958, f. 21-22.

¹³ *AIH*, A-IV-330, fl. 28.

¹⁴ Joseph Swire, *Shqipëria: Ngritja e një mbretërie*, Tiranë: "Dituria", 2005, f. 146.

përdorte në familje vetëm greqishten. Qëllimi ishte që në zonat ku popullsia fliste dy gjuhë, Komisioni Ndërkombëtar i Kufirit të konstatoje si gjuhë amtare, atë greke.

Ata që dyshoheshin se mund të shfaqnin ndjenja kombëtare shqiptare, pavarësisht besimit që praktikonin u arrestuan, u burgosën dhe u internuan. Njoftimet e konsujve austriake, britanikë dhe italianë informonin për shtimin e numrit të arrestimeve, veçanërisht në Çamëri, dhe transferimin e të burgosurve shqiptarëve nga burgjet e Gjirokastrës e Tepelenës në atë të Janinës¹⁵. Shtëpitë e shqiptarëve u vunë nën mbikëqyrjen e forcave ushtarake. Mësues nga gjimnazi dhe shkollat e Janinës u dërguan në kufi për të pritur Komisionin e Kufirit. Pavarësisht se kjo situatë ishte e evidente, ministrin i Jashtëm grek i sapo emëruar, Panas (Dimitrios Panas), në takimet diplomatike mohonte gjithçka¹⁶. Deklaratat e tij shprehnin mungesë informacioni dhe mosbesim për informatat, që bënin fjalë për terror të praktikuar nga autoritetet lokale greke në zonat e pushtuara.

Krahas masave me karakter propagandistik, në terren u ndërmorën edhe masa me karakter ushtarak. Raporti mes tyre arriti të gjente një baraspeshë. Në takimin e datës 10 dhjetor 1913 që ministri britanik në Athinë zhvilloi me kryeministrin grek konstatoi se qeveria greke inkurajonte dhe furnizonte me armë epirotët në rezistencën e tyre kundër vullnetit të Evropës¹⁷. Kreu i qeverisë greke nuk e mohoi inkurajimin dhe nxitjen e popullsisë për t'u "vetë armatosur", por ai nuk pranoi dërgimin e armëve, me përjashtim të 500 pushkëve në Himarë. Në fakt relacionet nga terreni bëjnë të besueshëm konstatimin e diplomatit britanik. Që në mes të gushtit të vitit 1913, konsulli francez në Janinë njoftonte Ministrinë e Jashtme se qeveria greke kishte "autorizuar rekrutimin e vullnetarëve brenda Greqisë dhe në zonat e pushtuara", veprim ky, që u

¹⁵ *AIH*, A-IV-253, Raport i konsullit britanik në Vlorë për Ministrinë e Jashtme, Vlorë: 25 tetor 1913; *HHSIA.PA.A.* në *AIH*, Vj. 23-12-1231, Raport i konsullit austriak në Janinë për Ministrinë e Jashtme, Janinë: 7 shtator 1913; *HHSIA.PA.A.* në *AIH*, Vj. 23-14-1473, Raport i anëtarit austro-hungarez në Komisionin e Kufirit për Ministrinë e Jashtme, Leskovik: 30 nëntor 1913.

¹⁶ *HHSIA.PA.A.* në *AIH*, Vj. 23-9-942, Raport i ministrit austriak në Athinë për Ministrinë e Jashtme, Athinë: 20 shtator 1913. Mbi takimin me ministrin e Jashtëm grek.

¹⁷ *AIH*, A-VI-39, viti 1913-1914, fl. 75-76, Raport i ministrit britanik në Athinë për Ministrinë e Jashtme, Athinë: 10 dhjetor 1913.

përsërit edhe gjatë muajit nëntor¹⁸. Të ardhurit përforcuan në një masë të konsiderueshme efektivat e divizioneve të ushtrisë së rregullt greke. Disa mijëra rekrutë u armatosën dhe u nisën në përforcim të garnizoneve greke në Tepelenë, Gjirokastrë, Korçë dhe Përmet. Një numër i konsiderueshëm ushtarësh grekë mbërritën në Sarandë dhe zonat rreth saj. Pothuajse çdo ditë atashu ushtarak francez në Athinë njoftonte se “oficerë që i përkasin divizioneve greke jashtë Epirit, janë hequr nga vendi i tyre dhe i janë bashkangjitur trupave të ushtrisë së Epirit... Lëvizja e tyre bëhet pa tërhequr vëmendje, qoftë me detashmente, qoftë me njerëz të izoluar...”¹⁹. Në fund të nëntorit të vitit 1913, përgatitjet për një rezistencë të armatosur ishin drejt fundit. Pritej vetëm preteksti për të rrokur armët.

Paralelisht me ushtrinë e rregullt greke në zonat e pushtuara të Shqipërisë së Jugut po organizohej “një tjetër” forcë e armatosur. Ajo duhej të vepronte si forcë e organizuar nga banorët e zonave të diskutueshme, të cilët duhej t’i rezistonin përfshirjes në shtetin shqiptar. U formuan kështu të ashtuquajturat “Batalione të Shenjta”²⁰. Në kohën e punimeve të Komisionit Ndërkombëtar të Kufirit Jugor, numri i tyre u rrit ndjeshëm. Batalionet e Shenjta u organizuan nga oficerët e ushtrisë greke²¹ dhe u pajisën me armë të ardhura nga Greqia²². Anëtarët e tyre

¹⁸ AMAE në AIH, F. 85, fl. 156, Raport i konsullit francez në Janinë për Ministrinë e Jashtme, Janinë: 23 gusht 1913; Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSh), Fondi 145 (Kryesia e qeverisë së Përkohshme të Vlorës), viti 1913, dos. III-5/2, fl. 674-677, Telegram i komandantit të xhandarmërisë së Qukësit për kryesinë e komunës, 18 shtator 1913; HHSIA.P.A.A. në AIH, Vj. 23-14-1473, Raport i delegatit austriak në Komisionin e Kufirit për Ministrinë e Jashtme, Leskovik: 30 nëntor 1913.

¹⁹ AMAE në AIH, F. 145, fl. 822, Raport i atashut ushtarak francez në Athinë për ministrin e Luftës, Athinë: 27 dhjetor 1913.

²⁰ “Batalionet e Shenjta” u krijuan nën shembullin e legjioneve të lashta të Tebës, të cilët ishin betuar se do të vdisnin duke luftuar, për të mos e lënë vendin e tyre të pushtohet nga ushtria e Filipit të Maqedonisë. Në vitin 1913-1914, “Batalionet e Shenjta” u krijuan në të gjithë territorin shqiptar, të pretenduar nga Greqia. Ata vepruan sipas modelit të kompanive të ushtrisë së rregullt greke. Batalioni i parë u krijua në Korçës në maj të 1913, në prag të vizitës së princit grek aty.

²¹ HHSIA.P.A.A. në AIH, Vj. 23-2-290, Raport i delegatit austriak në Komisionin e Kufirit për Ministrinë e Jashtme, Leskovik: 27 tetor 1913; AMAE në AIH, F. 145, fl. 822, Raport i atashut ushtarak francez në Athinë për ministrin e Luftës, Athinë: 27 dhjetor 1913.

²² AMAE në AIH, F. 85, fl. 156, Raport i konsullit francez në Janinë për Ministrinë e Jashtme, Janinë: 23 gusht 1913; HHSIA.P.A.A. në AIH, Vj. 23-12-1231,

dalloheshin nga ushtarët e rregullt grekë sepse mbanin në kapela inicialet I. L (Ieros Lohos= Batalione të Shenjta). Në këtë mënyrë po përgatitej terreni për ta kaluar rezistencën nga ushtria greke drejt Batalioneve të Shenjta. Çdo batalion kishte në përbërje të tij rreth 50 vetë, kryesisht vullnetarë prej ushtrisë greke, grekë dhe filo-grekë nga Shqipëria e Jugut, veteranë “epirotë” të Luftërave Ballkanike, rezervistë të thirrur nën armë nga diaspora greke e Amerikës, e Egjiptit, etj, keqbërës dhe kriminelë të liruar nga burgjet e Kretës.

Emërtimi i tyre si “Batalione të Shenjta” të bën të mendosh se rezistenca do të bëhej në emër të fesë, ç’ka nënkupton sjellje tejet agresive, veçanërisht ndaj popullsisë shqiptare myslimane. Sipas konsullit britanik në Vlorë “grekët po i përdorin të gjitha mjetet, përveç vrasjeve, për të terrorizuar dhe për ta bërë të heshtë atë pjesë të popullsisë, të cilën nuk kanë arritur ta bindin mbi origjinën e pastër helene, apo për të nxitur tek ajo simpatitë helene”²³. Veprimet e tyre të mbështetura edhe nga autoritetet administrative e ushtarake greke ishin akoma më cinike dhe brutale, në Çamëri. Ata kishin si qëllim të shuanin çdo shenjë që tregonte ekzistencën e një popullsie jo greke, para mbërritjes së Komisionit të Kufirit. Popullsia myslimane u dhunua dhe u grabit²⁴. Objektet e kultit, kryesisht ato të ritit bektashi, u shndërruan në kisha.

Në shërbim të çështjes kombëtare u vunë edhe Shoqëritë Panepirote. Javën e tretë të tetorit në Athinë u organizua mbledhja e kryesive të Shoqërisë Epirote të Athinës dhe të Pireut. Takimi përfundoi me krijimin e Komitetit “Mbrojtja Kombëtare”. Komiteti duket në marrëveshje me qeverinë greke mori përsipër rezistencën e armatosur në Shqipërinë e Jugut²⁵. Përballë presionit ndërkombëtar dhe interesave greke në ishujt e Egjeut, qeveria e Venizellosit (Eleftherios Venizelos)

Raport i Konsullit austriak në Janinë për Ministrinë e Jashtme, Janinë: 7 shtator 1913; *HHSStA.PA.A.* në *AIH*, Vj. 23-3-303, Telegram i Ministrisë së Jashtme të Austro-Hungarisë për ministrin në Romë, Vjenë: 4 dhjetor 1913.

²³ *AIH*, A-IV-253, Raport i konsullit britanik në Vlorë për Ministrinë e Jashtme, Vlorë, 25 tetor 1913.

²⁴ *AQSh*, Fondi 145, viti 1913, dos. II-62, fl. 43, Telegram i popullsisë së Kurveleshit për qeverinë e Vlorës, Kurvelesh: 21 nëntor 1913; *AIH*, A-IV-253, Raport i konsullit britanik në Vlorë për Ministrinë e Jashtme, Vlorë: 25 tetor 1913.

²⁵ *AIH*, A-VI-39, viti 1913-1914, fl. 49 Telegram i ministrit të Britanisë së Madhe në Romë për Ministrinë e Jashtme, Romë: 30 tetor 1913.

nuk mund të dilte hapur si organizatore e rezistencës në terren. Ajo duhej të dukej se ishte vepër e popullsisë vendase, e cila do të kundërshtonte bashkimin me Shqipërinë dhe “do të shpallte pavarësinë e Epirit të Veriut, edhe nëse qeveria greke nuk do të ishte aktive”²⁶. Komiteti u dërgoi thirrje të gjithë epirotëve dhe miqve të tyre dhe u kërkoi pjesëmarrje dhe ndihmë materiale në përgatitjen e rezistencës së armatosur.

Komiteti ngriti degë në të gjitha qytetet e Shqipërisë së Jugut, të pushtuara nga ushtria greke. Detyrë imediate e komiteteve lokale ishte regjistrimi i popullsisë në Batalionet e Shenjta. Për ta kryer më së mirë detyrën, ata bashkërenduan punën si me Batalionet e Shenjta ashtu edhe me autoritetet e larta fetare, veçanërisht me mitropolitin e Gjirokastrës dhe atë të Korçës. Sakaq nisi puna për të bindur popullsinë e Gjirokastrës dhe të Korçës për t’u regjistruar si vullnetare në formacionet e mësipërme. Për të nxitur pjesëmarrjen e shqiptarëve të krishterë u përdor propaganda me karakter fetar, sipas së cilës Shqipëria si shtet mysliman nuk kishte aspak mundësi që të ekzistonte dhe se ata duhet të ruheshin që të mos binin nën sundimin e bejlerëve myslimanë²⁷. Me krijimin e komiteteve lokale, Batalionet e Shenjta filluan të organizoheshin më mirë. Shumë shpejt komiteti i Gjirokastrës përgatiti edhe rregulloren për punën e Batalioneve të Shenjta²⁸. Masat shtrënguese dhe detyruese që

²⁶ *HHS*A.P.A.A. në *AIH*, Vj. 23-8-828, Telegram i konsullatës austro-hungareze në Korfuz për Ministrinë e Jashtme, Korfuz: 10 tetor 1913.

²⁷ *Po aty*, Vj. 23-14-1473, Raport i delegatit austriak në Komisionin e Kufirit për Ministrinë e Jashtme, Leskovik: 30 nëntor 1913.

²⁸ Rregullorja e “Batalioneve të Shenjta” u hartua vetëm në gjuhën greke. Ajo kishte 10 nene dhe filloi të zbatohet në fillim të nëntorit të vitit 1913. Sipas saj, Batalionet e Shenjta formoheshin jo vetëm në qytet por dhe në fshatra. Ata kishin flamurin e tyre me ngjyrë të kaltër, si flamuri i Greqisë, mbi të cilën shkruhej në të bardhë “Bashkim ose Vdekje” dhe nën të “Legjioni i Shenjtë i Gjirokastrës”. Batalionet kishin për detyrë të bënin organizimin ushtarak të banorëve dhe t’i stërvitnin ata. Rregullorja detyronte të gjithë meshkujt e qytetit dhe të fshatit nga mosha 19 deri 55 vjeç të regjistroheshin në “Batalionet e Shenjta”. Pjesë e tyre mund të ishin edhe gratë, të cilat nëse dëshironin mund të mbanin edhe armë. Hierollohitët, kështu quheshin anëtarët e Batalioneve të Shenjta, përgatiteshin nga oficerë grekë, 2 herë në javë, të martë dhe të enjte pasdite, për tre orë. Gjatë dy ditëve të stërvitjes, dyqanet e të krishterëve ishin të mbyllura pasdite. Ata që i hapnin gjobiteshin nga 5 deri në 100 drahmi. Stërvitja ushtarake ishte e detyruar. Në rast mungese të pajustifikuar, rezervistët gjobiteshin me 2 drahmi dhe në çdo dy mungesa gjoba dyfishohej. Ata që nuk pranonin të regjistroheshin si hierollohitë paguanin një gjobë nga 25 drahmi deri

përmbante ajo ndikuan në rritjen e pjesëmarrjes së shqiptarëve në Batalionet e Shenjta.

Në funksion të politikës shkëputëse u përdor gjerësisht edhe shtypi. Në fillim të tetorit 1913 në Korçë, Gjirokastrë dhe Delvinë dolën në qarkullim edhe tre gazeta të reja në gjuhën greke. Nëpër faqet e shtypit u pasqyrua gjerësisht i gjithë aktiviteti i mësipërm. Kolona të gjata me telegrame të adaptuara sipas shijes greke; akuza kundër delegatit italian dhe austro-hungarez të Komisionit Ndërkombëtar të Kufirit Jugor; lajme mbi mbështetjen që popullsia myslimane shqiptare i jepte bashkimit me Greqinë dhe pjesëmarrjen e tyre në Batalionet e Shenjta; kronika të shumta mbi hapjen e shkollave greke dhe frekuentimin e tyre nga fëmijët shqiptarë; thirrje entuziaste për luftë çlirimtare; kryeartikuj mbi paaftësinë shtet formuese të shqiptarëve dhe perspektivat e rivendosjes të një sundimi të tmerrshëm të bejlerëve atje; kronika tendencioze mbi keqbërjet masive të shqiptarëve ndaj popullsisë greke, etj.²⁹

Masat e mësipërme u hasën nga Komisioni i Kufirit gjatë punës së tij. Komisioni hyri në Shqipëri nga Korça, më 14 tetor 1913, por pa u ndalur aty sepse qyteti ishte vendosur që t'i mbetej Shqipërisë. Prej Korçës, ai shkoi në Ersekë ku qëndroi 22 ditë. Nga Erseka iu drejtua Leskovikut ku qëndroi pak më shumë se një muaj dhe prej andej mori rrugën për në Gjirokastrë, ku mbërriti më 8 dhjetor 1913. Himara nuk u përfshi në kalendarin e punës së Komisionit. Ndërkombëtarët në Londër kishin vendosur që ajo të ishte pjesë e shtetit shqiptar.

Në vendet ku kaloi dhe qëndroi, Komisioni u gjend nën pritjen ekzaltuese të popullsisë të veshur me fustanella të qëndisura e me flamuj grekë në duar; të nxënësve të shkollave; të klerit ortodoks; të “Batalioneve të Shenjta”; të burrave dhe të grave me armë në duar, të cilët në korr thërrisnin në gjuhën greke: “Rroftë Greqia”, “O me Greqinë ose vdekje”. Memorandume proteste iu dorëzuan anëtarëve të Komisionit³⁰. Por vizitat e rastësishme të tij në zonat e diskutueshme treguan një gjendje aspak ekzaltuese. Shumë shtëpi u gjetën të mbyllura. Në shtëpitë mikpritëse, gratë pavarësisht frikës që shprehnin, në

në 500, në varësi të vendimit të Komitetit Mbrojtja Kombëtare. Shih: *AIH*, A-IV-330, fl. 36-37.

²⁹ Shtypi grek është pasqyruar gjerësisht në raportet e konsujve austriakë. Shih: *HHSIA.PA.A.* në *AIH*, shtator-nëntor 1913.

³⁰ *AIH*, A-IV-206, fl. 15-22 (Jepet i plotë teksti i memorandumit që iu dha në Korçë, Komisionit Ndërkombëtar të Kufirit të Shqipërisë së Jugut).

përgjithësi flisnin shqip ose i përdornin të dyja gjuhët. Në shumë raste anëtarëve të Komisionit iu refuzua hyrja në shtëpitë vendase prej anëtarëve të Batalioneve të Shenjta, të cilët shkonin fshat më fshat me vrap për të arritur atje, para ardhjes së Komisionit³¹. Nga priftërinjtë dhe kryepleqtë, refuzimi i takimeve për ligje me zakonet e zonës, të cilat nuk u lejonin grave të krishtera të takoheshin me të huaj.

Masat e marra në terren arritën jo vetëm ta vononin punën e Komisionit, por edhe të shtronin për diskutim ndërprerjen e punës së tij. Në sajë të propozimit të delegatit britanik për një vijë kufitare kompromisi, pa vizituar të gjithë zonën e kontestuar dhe këmbënguljes së qeverisë së tij për t'i dhënë fund procesit të zgjatur të përcaktimit të kufirit shqiptaro-grek, Komisioni Ndërkombëtar i Kufirit pavarësisht divergjencave që manifestuan anëtarët e tij, vendosi ta përfundonte punën e nisur³². Pasi zhvilloi seancën e fundit më 10 dhjetor 1913 në Gjirokastër, ai u largua në drejtim të Firences, prej nga ku, më 17 dhjetor 1913 hartoi Protokollin mbi kufirin tokësor shqiptaro-grek. Protokollin që mban emrin e qytetit në të cilin u hartua, u firmos nga të gjashtë anëtarët e Komisionit Ndërkombëtar të Kufirit Jugor. Vija kufitare tokësore shqiptaro-greke ishte një zgjidhje diplomatike dhe politike mbështetur në të dhëna gjeografike dhe etnografike. Ajo prezantoi një kompromis të Fuqive të Mëdha, midis kërkesave të shqiptarëve, të cilat shtriheshin tej në Jug dhe pretendimeve greke, të cilat shkonin më në veri, deri në Himarë e Korçë. Si rezultat i kompromisit të arritur, distriktet e Korçës, Kolonjës, Përmetit dhe Gjirokastrës u përfshinë brenda shtetit shqiptar, ndërsa krahina e Çamërisë i kaloi përfundimisht Greqisë. Vija e Firences është thuhet vija e sotme e kufirit shqiptaro-grek³³. Pas nënshkrimit të Protokollit, Fuqitë e Mëdha morën angazhim të njoftonin Greqinë për vijën përfundimtare kufitare me Shqipërinë, duke e ftuar atë të hiqte dorë

³¹ Aneksi i procesverbalit të seancës së pestë, së gjashtë, së shtatë të Komisionit të Kufirit, Ersekë, 20, 21, 23 tetor 1913 në: Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit (Përmbledhje dokumentesh me një vështrim historik)*, Vëll. II (1912-1918), Tiranë: "8 Nëntori", 1984, f. 391, f. 397, f. 402.

³² Procesverbali i seancës së dymbëdhjetë dhe të trembëdhjetë të Komisionit të Kufirit", Leskovik: 24 nëntor dhe 5 dhjetor 1913 në A. Puto, *Çështja shqiptare në aktet...*, Vëll. II, f. 408-411.

³³ Për tekstin e tij shih, Procesverbalin e seancës së pesëmbëdhjetë të Komisionit të Kufirit, Firenze, 17 dhjetor 1913 në: A. Puto, *Çështja shqiptare në aktet...*, Vëll. II, f. 423-425.

nga kundërshtimi dhe të fillonte tërheqjen e ushtrisë nga territoret e shtetit shqiptar. Ushtria greke ndodhej 20 milje mbi vijën e Firences³⁴.

Reagimi diplomatik i Greqisë

Greqia vazhdoi të ishte kokëfortë në qëndrimin e saj. Ajo nuk e mbështeti vijën e propozuar nga delegati britanik në Komisionin Ndërkombëtar të Kufirit të Jugut. Më 25 nëntor 1912, në takimin që zhvilloi me ministrin e Jashtëm britanik, ministri grek në Londër protestoi në emër të qeverisë së tij ndaj propozimit britanik, pavarësisht se ai i jepte Greqisë një nga viset më të begata shqiptare, atë të Çamërisë. Sipas tij, vija e projektuar “i lë Shqipërisë shumë grekë, të cilët do të bien nën një sundim më pak të civilizuar se ai i Greqisë, të cilin ata nuk e aprovojnë dhe do të ngrenë krye”³⁵. Ministri i Jashtëm, Grey (Eduard Grey) e këshilloi seriozisht qeverinë greke që të pranonte çdo vendim të Fuqive, cilido të ishte ai.

Dy javë më vonë u vu re reflektimi i parë i qeverisë greke, e cila kishte filluar ta kuptonte se çështja e kufijve jugorë të Shqipërisë po merrte një kahje të kundërt me pretendimet greke³⁶. Për këtë arsye ajo filloi ta shtronte çështjen në trajtën “më jep të jap”, duke dëshiruar të këmbente zbrazjen e tokave shqiptare në Jug kundrejt kalimit të gjithë ishujve të Egjeut në duart e saj³⁷. Më 10 dhjetor 1913, në takimin që kryeministri grek bëri me ministrin britanik në Athinë, insistoi që çështja e kufirit me Shqipërinë të zgjidhej njëkohësisht me çështjen e ishujve të Egjeut. Sipas Venizellosit, nëse “flijimi i Epirit të Veriut ishte pjesë e pandarë e rregullimit të përgjithshëm, që i njihet dhe i siguronte Greqisë ishujt e pushtuar..., atëherë ndoshta ajo mund të tërhiqej”³⁸.

Por, ndërsa nga njëra anë vihet re një tërheqje me kushte e diplomacisë greke në dobi të respektimit të vendimeve të Fuqive të

³⁴ T.J. Winnifrith, *Badlands-Borderlands: A history of Northern Epirus\Southern Albania*, Duckworth: January, 2003, f. 130.

³⁵ *AIH*, A-VI-39, V. 1913-1914, fl. 69 Telegram i ministrit të Jashtëm të Britanisë së Madhe për ministrin britanik në Athinë, Londër: 25 nëntor 1913.

³⁶ Vasilis Kondis, *Greqia dhe Shqipëria* në shekullin e XX, Selanik: Paratiritis, 1997, f. 62.

³⁷ A. Puto, *Pavarësia e Shqipërisë dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha*, Tiranë: “8 Nëntori”, 1978, f. 554.

³⁸ *AIH*, A-VI-39, V. 1913-1914, fl. 75 Raport i ministrit britanik në Athinë për ministrin e Jashtëm të Britanisë së Madhe, Athinë: 10 dhjetor 1913.

Mëdha në lidhje me Shqipërinë, gjithnjë e më shumë po artikulohej prej saj rezistenca që “popullsia vendase” do t’i bënte bashkimit me Shqipërinë³⁹. Tanimë, qeveria greke deklaronte të ishte e sigurt se “populli i Epirit do t’i rezistojë me forcë aneksimit me Shqipërinë”⁴⁰. Po sipas saj, vendosmëria e popullsisë kufitare konfirmohej në çdo anë dhe reagimi i saj do të merrte përkrahje të fortë prej vullnetarëve nga Greqia. Ministri i Jashtëm grek shprehte bindjen se vështirësitë në zonat e pushtimit do të ishin shumë më të mëdha, në momentin e tërheqjes së ushtrisë greke⁴¹.

Deklaratat greke në dukje rritën shqetësimin pranë qeverisë britanike. Në notën që ministri i Jashtëm Britanik u dërgoi kancelarive të Fuqive të Mëdha, më datë 12 dhjetor 1913, konstatohej se në momentin kur Komisioni i Kufijve pothuajse kishte rënë dakord për vijën kufitare shqiptaro-greke, Fuqitë e Mëdha do të përballeshin me rezistencën e popullsisë së krishterë, në zonat kufitare⁴². Për të shmangur gjakderdhjen vijonte nota, duhej të fitohej bashkëpunimi i qeverisë greke për çështjen e kufirit me Shqipërinë, çka do të zhdukte në mënyrë të konsiderueshme vështirësitë në Shqipërinë e Jugut. Sikurse ishte shprehur vetë Venizellosi, bashkëpunimi i qeverisë së tij mund të fitohej vetëm nëse Greqia do të kishte përfitime në çështjen e ishujve të Egjeut. Çështja e ishujve vlerësohej prej tij si parësore në tërësinë e pretendimeve greke dhe e vështirë në realizimin e saj, pasi haste në kundërshtimin e vendosur të Perandorisë Osmane. Në mungesë të këtij rregullimi brenda Greqisë do të kishte turbullira, madje shtojte rreziku edhe për trazira të mëtejshme greko-osmane. Ishte në interes të gjithë Fuqive të Mëdha dhe të Perandorisë Osmane, theksonte Grey, që paqja e vendosur me shumë vonesë në Ballkan, të mos prishej sërish. Një rregullim sipas kushteve të

³⁹ Rezistenca kishte filluar të artikulohej nga zyrtarët grekë që në kohën kur Komisioni Ndërkombëtar i Kufirit ishte duke punuar në terren. Por, zyrtarët grekë i jepnin shqetësimin të tyre më shumë tone dyshimi duke mos shprehur siguri të plotë. Shih, *HHSIA.PA.A.* në *AIH*, Vj. 23-14-1439, Raport i ministrit austro-hungarez në Paris për Ministrinë e Jashtëme, Paris: 22 nëntor 1913, Mbi takimin me ministrin grek në Francë.

⁴⁰ *AIH*, A-VI-39, V. 1913-1914, fl. 75, Raport i ministrit britanik në Athinë për ministrin e Jashtëm të Britanisë së Madhe, Athinë: 10 dhjetor 1913.

⁴¹ *Po aty*, fl. 72 Raport i ministrit britanik në Vjenë për ministrin e Jashtëm të Britanisë së Madhe, Vjenë: 5 dhjetor 1913.

⁴² *Po aty*, fl. 79-81 Propozimet e ministrit të Jashtëm të Britanisë, Grey për Fuqitë e Mëdha, Londër: 12 dhjetor 1913.

vëna nga Venizellosi konsiderohej prej tij, i drejtë dhe praktik. Në emër të qeverisë së tij, ministri u kërkoi Fuqive të Mëdha të jepnin pëlqimin e tyre dhe të bashkëpunonin në realizimin e menjëhershëm të propozimit britanik, i cili kushtëzonte dhënien e ishujve të Egjeut me tërheqjen e ushtrisë greke nga tokat shqiptare⁴³.

Propozimi britanik i jepte kështu çështjes së ishujve të Egjeut, zgjidhjen e dëshiruar nga Greqia. Tashmë, të paktën nga pikëpamja diplomatike, qeveria greke nuk mund të rezistonte më, për Shqipërinë e Jugut. Në dallim nga qeveria, qëndrimi diplomatik i mbretit të Greqisë nuk manifestonte tërheqje. Pikëpamjet e tij dhe të opozitës ishin agresive dhe inkurajonin hapur rezistencën në mbrojtje të “çështjes së Epirit të Veriut”. Për to, Greqia duhej të vazhdonte të rezistonte në çështjen e kufirit me Shqipërinë, pavarësisht presionit të Fuqive të Mëdha. Në rast se Venizellos-i do të përulej para presionit ndërkombëtar, Mbreti shprehej i vendosur për të kaluar në masa ekstreme duke e larguar atë nga posti i kryeministrit dhe në rastin më të keq, do të abdikonte për të marrë kryesinë e mbrojtësve të vendit të tij⁴⁴.

Këto deklarata të krijojnë përshtypjen se në dhjetor të vitit 1913 politika greke manifestonte dy qëndrime. Nga njëra anë, qeveria më e kujdesshme në qëndrimin e saj linte të kuptohej se do të respektonte vendimet e Fuqive të Mëdha për Shqipërinë. Nga ana tjetër, mbreti dhe opozita të drejtpërdrejtë, tepër impulsivë dhe më të vendosur për të mbështetur dhe ndihmuar me të gjitha format veprimet e armatosur në viset e Shqipërisë së Jugut. Në këtë situatë, përpjekjet e qeverisë greke u përqendruan në tri drejtime kryesore: zvarritje e tërheqjes së trupave greke nga Shqipëria, rektifikim i mundshëm i vijës së Firences⁴⁵ dhe sigurim i të drejtave për popullsinë greke që përfundimisht ishte vendosur

⁴³ Në Traktatin e Athinës, nënshkruar më 14 nëntor 1913, mes Perandorisë Osmane dhe Greqisë, qeveria greke angazhohej t’ia linte në dorë Fuqive të Mëdha rregullimin e çështjes së ishujve të Egjeut.

⁴⁴ *HHSIA.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 23-34-3451, Raport i ministrit të Austro-Hungarisë në Athinë për ministrin e Jashtëm, Bertold, Athinë: 6 dhjetor 1913; *AIH*, A-VI-39, V. 1913-1914, fl. 76, Raport i ministrit britanik në Athinë për ministrin e Jashtëm të Britanisë së Madhe, Athinë: 10 dhjetor 1913.

⁴⁵ *AIH*, A-VI-39, V. 1913-1914, fl. 107-108, Raport i ministrit të Jashtëm grek, Grey për ministrin britanik në Athinë, Londër: 21 shkurt 1914. Mbi takimin me Venizellosin.

të ishte pjesë e shtetit shqiptar⁴⁶. Këto objektiva qeveria greke pretendoi t'i arrinte duke i dhënë një dimension të ri politikës së saj të jashtme.

Dimensioni i ri i politikës së jashtme greke

Në fillim të janarit të 1914, kryeministri grek nisi një tur diplomatik në disa kancelari të Fuqive të Mëdha. Qëllimi i shprehur i udhëtimit, ndër të tjera i shërbente zbutjes së kontrastit që mbizotëronte midis Greqisë dhe dy Fuqive të Adriatikut, i cili kishte arritur në një pikë dërmuese për interesat greke⁴⁷. Nëpërmjet shtendosjes së marrëdhënieve me Austro-Hungarinë dhe Italinë dhe në përgjithësi afrimit me Trepalëshin, pikë së pari, Greqia synonte të përfitonte në çështjen e ishujve të Egjeut. Po ashtu, ajo përfitonte në çështjen e kufirit me Shqipërinë, ku roli i Italisë dhe Austro-Hungarisë do të vazhdonte të ishte vendimtar edhe në të ardhmen. Afrimi me Fuqitë e Adriatikut, i shërbente edhe zbutjes së marrëdhënieve të acaruar të qeverisë me Mbretin, i cili në vazhdimësi kërkonte marrëdhënie të afërta me Trepalëshin. Orientimi i ri i qeverisë greke u bë i dukshëm në fillim të janarit të 1914, me emërimin e ministrit të Jashtëm, Streit (Georgios Streit), i cili shquhej për prirjet e tij pro austriake.

Ndërkohë edhe qeveria austro-hungareze kishte filluar të shfaqte shenja zbutjeje ndaj Greqisë. E ndikuar nga qëndrimi i vazhdueshëm i Gjermanisë, që “ka si qëllim t'i impresionojë grekët dhe t'i bëjë të mendojnë se ata kanë një mbështetje të rëndësishme nga shtetet e Aleancës Trepalëshe⁴⁸; interesat jo të drejtpërdrejta në territoret jugore shqiptare dhe dobësimin e pozitave të brendshme, Vjena kishte filluar të tërhiqej nga qëndrimet e palëkundura ndaj fqinjit jugor të Shqipërisë⁴⁹. Nga ana tjetër edhe homologia e saj italiane, ndonëse ishte më këmbëngulëse për shkak të interesave të drejtpërdrejta që kishte në territoret shqiptare dhe okupimin e një pjesë të ishujve të Egjeut, nuk shpërfillte asnjë mjet për të nxjerrë përfitime nga gjendja e krizave kronike ku përpëlitej Lindja dhe Ballkani. Në Ministrinë e Jashtme

⁴⁶ *HHSIA.PA.A.* në *AIH*, 22-18-1839, Diskutimi i ministrit të Jashtëm grek, Streit në parlamentin grek, dt: 24 maj 1914.

⁴⁷ *Po aty*, Diskutimi i Venizellosit në parlamentin grek, 24 maj 1914.

⁴⁸ *AMAE* në *AIH*, F. 147, fl. 1082-1083, Raport i Konsullatës së Francës në Ishujt Jonianë për ministrin e Jashtëm, Dumerg, Korfuz: 22 janar 1914.

⁴⁹ *AIH*, A-VI-39, V. 1913-1914, fl. 88 dhe 91, Raport i ministrit britanik në Vjenë për ministrin e Jashtëm, Grei, Vjenë: 23 dhjetor 1913 dhe 24 dhjetor 1913.

italiane ishin të vetëdijshëm se e kishin kaluar masën në sjelljen ndaj Greqisë⁵⁰. Në fillim të janarit 1914, Roma ishte e bindur se për momentin territoret shqiptare nuk do të bëheshin pjesë e shtetit grek⁵¹. E rëndësishme për të ishte të siguronte tërheqjen paqësore të ushtrisë greke nga Shqipëria e Jugut dhe veçanërisht nga brigjet karshi Korfuzit.

Në këtë situatë, dy Fuqitë e Adriatikut duket se do të bënin përpjekje për ta afruar Greqinë me Trepalëshin, duke e toleruar atë si në çështjen e kufirit me Shqipërinë ashtu edhe në atë të ishujve të Egjeut. Pas shtyrjes së parë të afatit të tërheqjes së ushtrisë greke nga Shqipëria e Jugut, hapi pasues ishte pritja dhe fryma mirëkuptuese që i shoqëroi takimet e Venizellosit në Romë dhe Vjenë. Prej ministrit francez në Romë pretendohet se në kryeqytetin italian u bë gjithçka për ta bërë për vete kryeministrin grek⁵². Ai u rrethua nga përkujdesjet më mikluese dhe shtypi e pasqyroj gjerësisht vizitën e tij.

Gjatë takimit me homologun e tij italian, Venizelloso shfaqti gatishmërinë e qeverisë së tij për të pranuar kufirin shqiptaro-grek, ashtu siç ishte caktuar prej Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, por me kusht që ishujt e Egjeut të okupuar prej Greqisë t'i mbeteshin asaj⁵³. Në përgjigje të qëndrimit të Italisë, që donte t'i mbante vetë ishujt e Dodekanezit, kryeministri grek nuk nguroi të rikthehej tek tokat shqiptare, duke deklaruar se "autoriteti i tij nuk mjaftonte për të ndaluar një rezistencë të mëvonshme të popullsisë"⁵⁴. Për t'i dalë përpara një eventualiteti të tillë, Venizelloso sugjeroi që zbrazja e territoreve të pushtuara të bëhej shkallë-shkallë dhe kërkoi një rektifikim kufiri në zonën e Gjirokastrës, në një sipërfaqe prej rreth 500km². Në këmbim, Greqia ishte gati të pranonte zgjatjen e bregdetit shqiptar nga kepi i Stylos në atë Paganian si dhe një dëmshpërblim prej 200.000 sterlinash në favor të Shqipërisë. Parimisht kryeministri italian nuk e kundërshtoi shkëmbimin e territorit në fjalë, por preferoi që fjalën e fundit ta thoshte

⁵⁰ AMAE në AIH, F. 145, fl. 1163-1164, Raport i ministrit francez në Itali për Ministrinë e Jashtme, Romë: 20 janar 1914.

⁵¹ HHSIA.PA.A. në AIH, Vj. 24-43-4394, Raport i ministrit të Austro-Hungarisë në Londër për ministrin e Jashtëm, Bertold, Londër: 2 janar 1914.

⁵² AMAE në AIH, F. 145, fl. 1163-1164, Raport i ministrit francez në Itali për Ministrinë e Jashtme, Romë: 20 janar 1914.

⁵³ AIH, A-VI-39, V. 1913-1914, fl. 164-165, Raport i ministrit britanik në Itali për ministrin e Jashtëm, Grei, Romë, 9 janar 1914. Mbi takimin e Venizellosit me San Xhulianon.

⁵⁴ A. Puto, *Pavarësia e Shqipërisë...*, f. 557-558.

pasi të kishte diskutuar me aleatët. Në takim mund të jetë diskutuar edhe në lidhje me garancitë që do t'i jepeshin popullsisë greke, tashmë pjesë e shtetit shqiptar. Shtypi francez në kohën e vizitës bënte fjalë për një akord mes Italisë dhe Austro-Hungarisë në lidhje me garancitë ndaj grekëve, banorë të Shqipërisë⁵⁵. Kryeministri italian duhet t'i kishte premtuar kryeministrin grek garanci, por pa hyrë në hollësi.

Suksesi i takimit mes kryeministrin italian dhe atij grek i dha frytet shpejt. Në mes të janarit 1914, Fuqitë e Trepalëshit bënë një kthesë në lidhje me çështjen e Ishujve, duke pranuar propozimin britanik të 12 dhjetorit, e vijuar kjo, edhe nga një shtyrje e dytë e afatit të tërheqjes së ushtrisë greke, nga 18 në 31 janar 1914.

Në fund të janarit 1914, Venizellosi mbërriti në Vjenë. Në takimin e zhvilluar me homologun austro-hungarez, kryeministri grek guxoi më shumë. Ai diskutoi aty mbi idenë e autonomisë administrative për Jugun e Shqipërisë dhe angazhimin e Batalioneve të Shenjta në sigurimin e rendit lokal pas tërheqjes së ushtrisë greke, deri në momentin kur xhandarmëria shqiptare të ishte në gjendje ta kryente vetë atë detyrë. Takimi në Vjenë rezultoi i frytshëm. Ministri i Jashtëm austro-hungarez në marrëveshje me qeverinë italiane, propozoi një shtyrje të tretë të afatit të tërheqjes së ushtrisë greke, nga 31 janari më 1 mars 1914 dhe pranoi propozimin grek që tërheqja e ushtrisë, të bëhej shkallë-shkallë⁵⁶.

Pranimi i propozimit të Greit nga të gjashtë Fuqitë e Mëdha, i hapi rrugë notave përkatëse në Athinë dhe në Stamboll. Nota që Fuqitë e Mëdha dërguan në kryeqytetin grek, më 13 shkurt 1914, nuk kishte përmbajtje të panjohur. Ajo përmblihte të gjitha zhvillimet diplomatike të dy muajve të fundit. Fuqitë e Mëdha ndonëse me vonë, rreth dy muaj pas nënshkrimit të Protokollit të Firences, njoftonin qeverinë greke mbi ratifikimin e tij dhe dhënien de jure Greqisë të pothuajse të gjithë ishujve të Egjeut. Përjashtim bënin vetëm tre ishuj: Imbros, Tenedos dhe Kastellorizos, të cilët Greqia duhet t'ia kthente Perandorisë Osmane. Dhurimi përfundimtar i ishujve do t'i bëhej Greqisë “veçse kur trupat greke të kenë zbrazur ishullin e Sazanit dhe territoret që i janë njohur Shqipërisë me Protokollin e Firences” dhe “qeveria greke të angazhohej formalisht për të mos inkurajuar as direkt, as tërthorazi ndonjë rezistencë të çdo natyre qoftë, kundrejt gjendjes së vendosur nga Fuqitë e Mëdha në

⁵⁵ *Echo de Paris*, 14 janar 1914.

⁵⁶ A. Puto, *Pavarësia e Shqipërisë...*, f. 557-559.

Jug të Shqipërisë”⁵⁷. Zbrazja do të bëhej shkallë-shkallë. Ajo do të fillonte më 1 mars 1914 me krahinën e Korçës dhe ishullin e Sazanit dhe do të përfundonte brenda muajit, më 31 mars 1914 me krahinën e Delvinës. Duket se Fuqitë e Mëdha nuk kishin arritur një mendim unik në lidhje me çështjen e garancive për popullsinë e pretenduar greke, të kërkuara hapur nga Venizellosi gjatë turit diplomatik, përderisa kjo çështje nuk përmendej në notë.

Më 21 shkurt 1913 pranë kancelarive të Fuqive të Mëdha mbërriti nota përgjigje e qeverisë greke⁵⁸. Toni i saj ishte pajtues, duke i dhënë fund zyrtarisht kokëfortësisë diplomatike greke për të mbajtur të pushtuara territoret e Shqipërisë së Jugut. Në notë, ajo deklaronte gatishmërinë e saj për t’u pajtuar me vendimin e Fuqive të Mëdha për Shqipërinë dhe për të tërhequr ushtrinë nga territoret e shtetit shqiptar, në përputhje me afatet e caktuara. Qeveria greke merrte angazhimin formal për të mos bërë asnjë rezistencë dhe për të mos inkurajuar drejtpërdrejtë ose tërthorazi ndonjë rezistencë kundrejt gjendjes së vendosur nga Fuqitë e Mëdha në jug të Shqipërisë. Gjithashtu, ajo pranonte të kontribuonte për të qetësuar popullsinë, në momentet kritike që ajo po kalonte.

Më shumë se një notë përgjegjësish, ajo ishte një notë e mbushur plot me kërkesa. Nën frymën e bisedave që kryeministri grek kishte zhvilluar në kancelaritë evropiane gjatë janarit, qeveria greke vazhdoi të kërkonte rektifikim kufijsh në luginën e Gjirokastrës (Aneksi A) dhe të këmbëngulte në çështjen e “garancive të mjaftueshme dhe efikase”, për të gjithë popullsinë ortodokse në Shqipëri, të cilën në vazhdimësi e konsideronte greke. Garancitë duhej të përfshinin të drejtën e pronës së trashëgueshme, gjuhës, besimit dhe organizimit kishtar. Garantimi i tyre ishte një rrugë e qetë për të siguruar atë çka Greqia synonte. Nëpërmjet tyre elementi i krishterë, i pretenduar si grek, siguronte një pozitë të veçantë brenda shtetit shqiptar duke u mbrojtur nga “shqiptarizimi”, dhe njëkohësisht i gatshëm për t’u bashkuar në një kohë të favorshme, me Greqinë⁵⁹. Zona e Himarës zinte një vend specifik në notë. Fakti që ajo, në kohën e Perandorisë Osmane kishte gëzuar një autonomi të gjerë,

⁵⁷ *AIH*, A-VI-39, V. 1913-1914, fl. 170-171. Notë e Fuqive të Mëdha për qeverinë greke, 13 shkurt 1914.

⁵⁸ *Po aty*, fl. 172-175. Notë përgjigje e qeverisë greke dërguar Fuqive të Mëdha, Athinë: 21 shkurt 1914.

⁵⁹ *HHSIA.PA.A.* në *AIH*, Vj. 24-5-594, Raport i ministrit të Austro-Hungarisë në Athinë për Ministrinë e Jashtme, Athinë, 28 shkurt 1914.

duhej të merrej parasysh prej Fuqive të Mëdha. Nota ishte kështu një hap i rëndësishëm drejt autonomisë administrative për territoret jugore të shtetit shqiptar, duke lënë kështu të hapur çështjen e bashkimit të tyre me Greqinë, në të ardhmen e afërme⁶⁰.

Nga diplomacia në veprime të armatosura

Zhvillimet në politikën ndërkombëtare dhe atë greke, u reflektuan edhe në territoret e pushtuara në Shqipërinë e Jugut. Njëpërmjet terrenit qeveria greke synonte të shpëtonte atë ç'ka nuk kishte mundur ta bënte diplomacia, jetësimin e shkëputjes. Në periudhën dhjetor 1913 e deri në shkurt të vitit 1914, vihet re se masat propaganduese gjithnjë e më shumë u zvogëluan, ndërsa ato me karakter ushtarak u bënë mbizotëruese. Në fillim të dhjetorit 1913 guvernatori dhe i komandanti i Përgjithshëm i Epirit, Zografos (Georgios Zografos) shprehej i bindur se qeveria greke e kishte humbur fushatën diplomatike në çështjen e kufirit me Shqipërinë, sepse Britania e Madhe me propozimin e saj ndërmjetësues ishte ndarë nga Antanta dhe kishte braktisur Greqinë. Ai pretendonte se “epirotëve” nuk u mbetej gjë tjetër veçse të mbronin me armë në dorë të drejtat e marra nëpër këmbë. Ai shprehte siguri se veprimet e tyre kishin për të gjetur mbrojtjen këmbëngulëse të Greqisë⁶¹.

⁶⁰ Nota greke ishte surprizuese në dy momente. Së pari, në kërkesën për të inkuorporuar në xhandarmërinë shqiptare elementë lokalë grekë, me arsyetimin se ajo ishte një masë që do të siguronte popullsinë e Jugut se jeta dhe prona e saj nuk do të prekeshin. Kjo sepse ata ishin “elementë të stërvitur, me disiplinë dhe me influencë në popull”. Në fakt më shumë se sa siguri, futja në xhandarmërinë shqiptare e elementëve grekë (nënkupto e Batalioneve të Shenjta), do të shkaktonte tension dhe acarim në shumicën e popullsisë shqiptare, e cila kishte kohë që ndiente presionin dhe shtypjen greke. Momenti i dytë ishte aneksi B i notës, i cili kërkonte rektifikim në zonën e Korçës. Sipas frazave të fundit të notës, “qeveria mbretërore merr angazhimin formal të tërheqë trupat e saj prej çdo pike të okupuar, që përfundimisht nuk i jepet Greqisë”. Meqenëse Komisioni Ndërkombëtar i Kufirit Jugor nuk i kishte marrë në shqyrtim kufijtë në zonën e Korçës, të krijohet përshtypja se Greqia nuk e konsideronte përfundimtar kufirin në atë zonë. Duke kërkuar një rishikim të kufirit aty, ajo pretendonte se ishte më e arsyeshme që trupat greke, në përlligje të vendimit të Fuqive të Mëdha, ta fillonin zbrazjen me zonën e Korçës, por të ndalonin në kufijtë natyralë, duke mos u tërhequr përfundimisht nga krahina. Qeveria greke kërkonte që Fuqitë e Mëdha nëpërmjet një komisioni për caktimin e kufijve të bënin ndryshime kufitare, për të siguruar marrëdhënie të mira mes Greqisë dhe Shqipërisë.

⁶¹ *HHSStA.PA.A.* në *AIH*, Vj. 23-2-292, Raport i delegatit austro-hungarez në Komisionin Ndërkombëtar të Kufirit për Ministrinë e Jashtme, Janinë: 2 dhjetor 1913.

Por relacionet e diplomatëve në terren tregonin një situatë jo aq optimiste. Popullsia “epirote” nuk ishte aq e gatshme të rrokte armët, siç pretendonte guvernatori i Përgjithshëm i Epirit. Sipas konsullit francez në Manastir, në Ballkan ishte tejet e vështirë për të bërë parashikime. Në Korçë përpjesëtimi i banorëve të prirur për të mbrojtur të drejtat e helenizmit nuk i kalonte të 20%⁶². Në mitingun e fundit të organizuar diku nga fundi i dhjetorit 1913, në mbështetje të bashkimit me Greqinë, në shesh nuk u mblodhën më shumë se një mijë vetë. Pjesëmarrja e dobët ndikoi që në Korçë t’i jepej fund manifestimeve publike⁶³. Edhe mendimet mbi reagimin e armatosur që popullsia mund të ndërmerre pas zbrazjes së Korçës prej ushtrisë greke, nuk ishin unike. Kishte nga ata që besonin se do të kishte rezistencë të ashpër, sikurse të tjerë nuk besonin në ndonjë kundërshtim serioz⁶⁴. Qëndresa pretendohet të ishte shumë më e fortë në Himarë. Ajo i detyrohej veçanërisht nxitjeve të Spiro Spiromilos, sepse “në popull manifestohej interes për të rifilluar marrëdhëniet tregtare me Vlorën dhe për t’u marrë vesh me qeverinë shqiptare aty”. Kusht i vetëm i bashkëpunimit ishte mbajtja e privilegjeve të vjetra të kohës osmane⁶⁵. Në Gjirokastrë, partia e rezistencës vazhdonte të numëronte anëtarë të pasionuar, por numri dhe ndikimi i tyre dukej në pakësim e sipër, pasi popullsia po ndërgjegjësoj për dëmet e luftës⁶⁶. Shpirti i rezistencës aty ishte mitropoliti Vasilios (Basilios). Ai predikonte hapur qëndresë dhe rezistencë, duke qenë i vendosur të luftonte deri në fund, pavarësisht qëndrimit që qeveria greke do të mbante ndaj presionit të Fuqive të Mëdha. “Gjendja jonë është si ajo e të dënuarit me vdekje, që nuk ka se çfarë të humbasë”- shprehej ai në takimin me zëvendëskonsullin francez në Janinë⁶⁷.

Po cili ishte qëndrimi i qeverisë greke?

⁶² AMAE në AIH, F. 146, fl. 913-914, Raport Konsullatës së Francës në Manastir për Ministrinë e Jashtme, Manastir: 5 janar 1914.

⁶³ Po aty.

⁶⁴ HHSIA.PA.A. në AIH, Vj. 23-2-258, Raport i konsullit të Austro-Hungarisë në Manastir për ministrin e Jashtëm, Bertold, Manastir: 17 dhjetor 1913.

⁶⁵ AMAE në AIH, F. 145, fl. 728-730, Raport delegatit francez në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit për Ministrinë e jashtme, Vlorë: 16 dhjetor 1913.

⁶⁶ Po aty, F. 148, fl. 1455-1486, Raport ZV\Konsullatës së Francës në Janinë për Ministrinë e Jashtme, Janinë: 19 shkurt 1914.

⁶⁷ Po aty, F. 147, fl. 1317-1318, Raport ZV\Konsullatës së Francës në Janinë për Ministrinë e Jashtme, Janinë: 31 janar 1914.

Të paktën deri në fillim të shkurtit 1914, kryeministri i Greqisë ishte i dashuruar me idenë se “epirotët do të rezistojnë gjatë, duke dhënë të paktën provën e pakundërshtueshme të urrejtjes së tyre kundrejt zgjedhës shqiptare...”⁶⁸. Në përfundim të punës së Komisionit Ndërkombëtar të Kufirit të Jugut, rezistenca në Shqipërinë e Jugut vazhdoi të organizohej në mënyrë shqetësuese. “Bashkëfajësia greke as që mund të vihet në dyshim”, shprehej anëtari francez i Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, në një prej raporteve dërguar kryeministrit dhe ministrit të Jashtëm francez⁶⁹. Po sipas tij, qeveria e Athinës kishte organizuar në zonën e pushtuar batalionet e vullnetarëve; kishte autorizuar hyrjen e armatimeve dhe agjentëve grekë, që vazhdonin të punonin zellshëm për të ndezur shpirtrat e popullsisë⁷⁰. Po ashtu, qeveria greke kishte dërguar shuma të hollash; kishte lejuar të niseshin në drejtim të zonës së pushtuar një numër i madh vullnetarësh dhe oficerësh⁷¹ dhe kishte vazhduar të inkurajonte nën dorë përgatitjet për luftë⁷².

Autoritetet ushtarake greke morën pjesë aktivisht në përgatitjet për rezistencë. Ato vijuan armatosjen e “Batalioneve të Shenjta” dhe përshpejtuan instruksionet ushtarake për popullsinë duke parashikuar një qëndresë eventuale⁷³. Në fund të dhjetorit 1913, Konsullata e Austro-Hungarisë në Manastir njoftonte se sipas udhëzimeve të qeverisë greke ishte vendosur që ushtarët dhe oficerët greke, pasi t’u hiqej shenja ushtarake të qëndronin në Shqipëri⁷⁴. Krahas drejtimit të Batalioneve të

⁶⁸ *AIH*, A-VI-39, V. 1913-1914, fl. 127-128, Raport i ministrit të Britanisë në Athinë për ministrin e Jashtëm, Grei, Athinë, 5 mars 1914. Mbi takimin me Venizellosin.

⁶⁹ *AMAE* në *AIH*, F. 145, fl. 728-730, Raport delegatit francez në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit për Ministrinë e Jashtme, Vlorë: 16 dhjetor 1913.

⁷⁰ *Po aty*, fl. 813-815, Raport delegatit francez në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit për Ministrinë e jashtme, Vlorë: 21 dhjetor 1913.

⁷¹ *AMAE* në *AIH*, F. 146, fl. 898, Telegram i ministrit francez në Vjenë për Ministrinë e Jashtme, Vjenë: 6 janar 1914.

⁷² *Po aty*, F. 145, fl. 822, Raport i atasheut ushtarak francez në Athinë për ministrin e Luftës, Athinë: 27 dhjetor 1913; *AIH*, A-VI-39, V. 1913-1914, fl. 127-128, Raport i ministrit të Britanisë së Madhe në Greqi për ministrin e Jashtëm, Grei, Athinë, 5 mars 1914. Mbi takimin me Venizellosin.

⁷³ *AMAE* në *AIH*, F. 145, fl. 728-730, Raport delegatit francez në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit për Ministrinë e Jashtme, Vlorë: 16 dhjetor 1913.

⁷⁴ *HHSStA.PA.A.* në *AIH*, Vj. 23-4-480, Telegram i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë për ministrin në Romë, Vjenë: 20 dhjetor 1913. Mbi raportin e Konsullatës në Manastir.

Shenjta, ata u ngarkuan të rekrutojnë edhe vullnetarë, me të cilët konsulli francez në Manastir nënkuptonte “ushtarët e ushtrisë greke që kishin lënë uniformën”⁷⁵. Një pjesë e anëtarëve të ushtrisë greke filloi të jepte dorëheqjen, të tjerë pasi morën lehtësisht “leje të pakufizuar nga ushtria greke”, shtuan radhët e “Batalioneve të Shenjta”⁷⁶. Pjesa e mbetur, ndonëse vazhdoi shërbimin në ushtrinë greke, ishte e gatshme të grumbullohej me sinjalin e parë. Rekrutime të tjera u bënë nga rekrutë me origjinë nga rrethi i Vodenës. “Batalionet e Shenjta” u përforcuan edhe me kontingjente të freskëta “kokëkrisurish” nga Kreta dhe krerë të çetave greke që vepronin në Maqedoni⁷⁷.

Në terren po bëheshin përgatitje për veprime të armatosura, të cilat do të kundërshtonin vendimet e Fuqive të Mëdha dhe “pushtimin e Epirit të Veriut” nga shqiptarët. Plani i ngjizur në Athinë synonte që popullsia e Shqipërisë së Jugut të deklaronte menjëherë autonominë dhe në vazhdim të ngjarjeve, të bëhej bashkimi i tyre me Greqinë⁷⁸. Në mbështetje të planit “qeveria greke inkurajoi formimin e një qeverie autonome në Epir”

⁷⁵ *AMAE* në *AIH*, F. 146, fl. 913-914, Raport Konsullatës së Francës në Manastir për Ministrinë e Jashtme, Manastir: 5 janar 1914.

⁷⁶ *Po aty*, F. 145, fl. 822, Raport i atasheut ushtarak francez në Athinë për ministrin e Luftës, Athinë: 27 dhjetor 1913.

⁷⁷ Është e vështirë të japësh një numër të saktë për numrin e anëtarëve të Batalioneve të Shenjta dhe pjesëmarrjen e shqiptarëve në to. Ajo që vihet re veçanërisht pas përcaktimit të kufirit shqiptaro-grek është rritja e numrit të të ardhurve nga Greqia. Kjo besoj se lidhet edhe me faktin se popullsia shqiptare, nuk iu përgjigj në mënyrë masive siç grekët dëshironin, urdhrave për mobilizim ushtarak. Relacionet që vijnë nga terreni janë të ndryshme. Sipas konsullit francez në Korfuz në fillim të janarit 1914, anëtarët e Batalioneve të Shenjta kapnin shifrën e 17.000 vetëve, nga të cilët rreth 8000 ishin kretanë. Po sipas të njëjtit burim, në shkurt të po atij viti, numri i anëtarëve të Batalioneve thuhet se kap shifrën e 60.000 vetëve. Sipas konsullit të nderit të Austro-Hungarisë në Janinë, Batalionet e Shenjta kishin rreth 14.000 vetë nga të cilët 7000 ishin vullnetarë, ndërsa kretanët kapnin një shifër prej rreth 200-300 vetë. Shih: *AMAE* në *AIH*, F. 146, fl. 960-962, Raport i konsullit të Francës në Korfuz për kryeministrin dhe ministrin e Jashtëm, Dumerg, Korfuz: 9 janar 1914; *Po aty*, F. 148, fl. 1373, Raport i konsullit të Francës në Korfuz për kryeministrin dhe ministrin e Jashtëm, Dumerg, Korfuz: 8 shkurt 1914; *HHSStA.PA.A.* në *AIH*, Vj. 24-8-839, Raport i konsullit të nderit të Austro-Hungarisë në Janinë për ministrin e Jashtëm, Bertold, Janinë: 7 shkurt 1914.

⁷⁸ *HHSStA.PA.A.* në *AIH*, Vj. 23-21-2114, Raport i ministrit të Austro-Hungarisë në Perandorinë Osmane për ministrin e Jashtëm, kontin Bertold, Stamboll: 17 dhjetor 1913.

me seli në Gjirokastrë⁷⁹. Në fund të dhjetorit 1913, dy komandantë të ushtrisë së rregullt greke, Altiparma dhe Melas (Basil Melas) të shoqëruara nga A. Karapanos (Aleksandros Karapanos), nip i Zografosit dhe deputet në parlamentin grek, u nisën nga Saranda për në Janinë. Në fillim të janarit 1914, konsulli francez në Korfuz ndër të tjera shtonte se kryetari i qeverisë që pritej të krijohej do të ishte Zografosi, i cili në 31 dhjetor 1913 kishte dhënë dorëheqjen nga posti i guvernatorit të Përgjithshëm të Epirit. Anëtarë e saj do të ishin edhe Karapanosi, Dhulis (Dimitrios Dulis) dhe Kryepeshkopi i Konicës, Spiridhonas⁸⁰. Informacione të njëjta jepen edhe nga dokumentacioni austro-hungarez. Në fund të dhjetorit 1913, i ngarkuari me punë i Austro-Hungarisë në Londër, informonte se “Greqia mbas rregullimit përfundimtar të kufirit të Shqipërisë jugore, do të zbrazti tokat shqiptare, por në Gjirokastrë ajo do të vendosi një lloj qeverie provizore jo zyrtare, detyra e së cilës do të jetë përgatitja e deklaratimit të autonomisë së këtij distrikti”⁸¹.

Por rezultatet e turit ndërkombëtar të Venizellosit dhe veçanërisht nota e Fuqive të Mëdha e 13 shkurtit 1914, përshtati planet e qeverisë greke. Ajo kuptoi rrezikun që i vinte nga gjetja përgjegjëse për organizimin e hapur të rezistencës në Jug të Shqipërisë. Nga ana tjetër, qëndrimi jo mbështetës që në përgjithësi shqiptarët mbajtën ndaj organizimit të rezistencës së armatosur, si dhe roli që ndërkombëtarët do të kishin në organizimin e xhandarmërisë shqiptare, i kishin lënë Athinës të kuptonte, se “epirotët” do ta kishin të pamundur të përballonin rezistencën pa ndihmën e Greqisë. Në takimin që kreu i qeverisë greke pati më 22 shkurt 1914 me ministrin britanik në Athinë, nuk ngurroi të pohonte se në rast se do të kishte shpresën më të vogël që popullsia greke do t’i bënte ballë pa ndihmë shqiptarëve, do ta lejonte pa hezitim, atë provë. Ajo që Fuqitë e mëdha kërkonin prej tij ishte vetëm tërheqja e ushtrisë dhe mos inkurajimi direkt apo tërthorazi i rezistencës⁸².

⁷⁹ AMAE në AIH, F. 145, fl. 813-815, Raport delegatit francez në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit për Ministrinë e Jashtëme, Vlorë: 21 dhjetor 1913.

⁸⁰ *Po aty*, F. 146, fl. 960-962, Raport i konsullit të Francës në Korfuz për kryeministrin dhe ministrin e Jashtëm, Dumerg, Korfuz: 9 janar 1914.

⁸¹ HHSIA.PA.A. në AIH, Vj. 23-4-476, Raport i të ngarkuarit me punë të Austro-Hungarisë në Angli për ministrin e Jashtëm, kontin Bertold, Londër: 27 dhjetor 1913.

⁸² AIH, A-VI-39, V. 1913-1914, fl. 120-121, Raport i ministrit të Britanisë së Madhe në Greqi për ministrin e Jashtëm, Grei, Athinë, 22 shkurt 1914. Mbi takimin me Venizellosin.

Ndërkohë, Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit mori në shqyrtim çështjen e legjitimitetit të shkollave greke në Shqipëri. Në mbledhjen e tij të datës 20 shkurt 1913, ai diskutoi mbi shfuqizimin e vendimit të qeverisë së Vlorës për shkollat jo publike⁸³. Përfaqësuesi i Shqipërisë në Komision, Mehdi Frashëri e kundërshtoi shfuqizimin e vendimit sepse e kishte të pamundur të pranonte që arsimimi i fëmijëve shqiptarë të bëhej në gjuhën greke. Disa ditë më pas, më 24 shkurt 1914, pa pjesëmarrjen e delegatit shqiptar, Komisioni vendosi që “Rihapja e shkollave shqiptare ortodokse do të pranohet me kusht që mësimet të bëhen në gjuhën shqipe, që mësuesit të mos jenë të huaj, përveçse në ato vende ku nuk mund të sigurohen mësues shqiptarë. Mësimi i fesë do të zhvillohet në gjuhën greke. Në vendet ku nuk ka shkolla dhe as mësues shqiptarë ortodoksë, shkollat provizore do të funksionojnë si më parë, deri në fund të vitit shkollor”. Mehdi Frashëri pranoi vendimin e mësipërm, më 26 shkurt 1914.

Tashmë, qeveria greke duhej të ishte e kënaqur sepse Fuqitë e Mëdha kishin hedhur hapin e parë për t’i dhënë Greqisë atë që nuk e kishin bërë në notë, “garancitë e mjaftueshme dhe efikase” për popullsinë e pretenduar greke. Kjo linte të kuptohej se në shpërblim të një politike paqësuese në territoret e rivendikuara, qeveria greke do të kishte mundësi të siguronte garancitë e kërkuara për popullsinë greke.

Në këto kushte politika greke edhe në terren duhej të manifestonte po atë tërheqje që kishte shprehur në diplomaci. Ajo nuk mund të ishte aktive në organizimin e mëtejshme të rezistencës, sikurse ishte bërë deri më tani në zonën e pushtuar. Ishte koha që ajo të fshihte bashkëfajësinë e saj, të tregonte besnikërinë ndaj vendimeve të Fuqive të Mëdha, duke u përpyekur të qetësonte shpirtat e ndezur të rezistencës. “Sikur të kishte diçka që t’i bënte Fuqitë e Mëdha të mendonin se ne ndiqnim me këmbëngulje autonominë për t’ia shkullur Shqipërisë, Epirin e Veriut,

⁸³ Në shtator 1913, me fillimin e vitit shkollor 1913-1914, ministri i Arsimit në qeverinë së Vlorës nxori një shpallje në lidhje me hapjen e shkollave të huaja, jo shtetërore. Sipas saj “çdo shkollë e veçantë nuk do të hapet në Shqipëri pa marrë më parë lejen zyrtare nga qeveria e Vlorës”. Këto shkolla do t’i nënshtroheshin ligjeve të shtetit shqiptar. Leja jepej nëse shkollat plotësonin kushtin e vënë nga qeveria shqiptare që mësimi të bëhej në gjuhën shqipe. Programi, librat dhe diplomat e mësuesve miratoheshin dhe kontrolltoheshin nga Ministria e Arsimit. Shkollat në gjuhën greke, të cilat kishin vepruar në Shqipëri, prekeshin direkt prej këtij ligji.

sigurisht që ne nuk do të përfitonim atë që kemi përfituar” - shprehej në parlament, ministri i Jashtëm grek, Streit⁸⁴.

Besnikëria greke ndaj vendimeve të Fuqive të Mëdha u shfaq kryesisht në krahinën e Korçës. Kjo jo rastësisht. Korça, ishte zona për të cilën ndërkombëtarët kishin vendosur që në gusht të 1913, se do t'i përkiste Shqipërisë. Komisioni Ndërkombëtar i Kufijve nuk kishte hetuar aty dhe përpjekjet greke për rezistencë kishin siguruar pak mbështetës. Ndjenjat pro shqiptare të zonës, pavarësisht presionit të administratës greke, në përgjithësi kishin mbetur të forta. Në fund të janarit 1914, kryeministri Venizellos urdhëroi autoritetet ushtarake të pushtimit në Korçë të ndalonin çarmatimin e popullsisë myslimane dhe t'i rikthenin asaj armët e konfiskuara; të fillonin çarmatimin e trupave të armatosura “epirote” dhe të mos lejonin hyrjen e tyre në krahinë; të ndalonin keqtrajtimin e komunitetit shqiptar dhe të kultivonin sa të ishte e mundur marrëdhënie të mira midis grekëve dhe fqinjëve shqiptarë⁸⁵. Në buletin zyrtar të datës 24 shkurt 1914, qeveria greke njoftoi për tërheqjen e ushtrisë nga territoret e pushtuara dhe instrukttoi oficerët e lartë për mënyrën se si do të kryhej ajo⁸⁶. Komandanti i trup armatës së Janinës, Papulas (Anastasios Papoulas) u ngarkua të siguronte evakuimin e trupave greke nga Shqipëria. Ai u udhëzua prej qeverisë së tij të shkonte në zonën e pushtuar, të merrte masa energjike për të mbajtur rendin duke shtypur çdo përpjekje rezistence, madje të tregohet dashamirës ndaj autoriteteve shqiptare në kohën e kalimit të pushtetit⁸⁷. Qeveria greke njoftoi se zbrazja do të fillonte më 1 mars 1914 dhe se ajo nuk ishte aspak dakord me “lëvizjen në Epirin e Veriut” dhe përgjegjësinë për viktimat e mundshme të saj ia ngarkonte atyre që po e çonin popullin epirot në vetëvrasje⁸⁸. Me të mbërritur në Korçë, më 25 shkurt 1914, Papulasi njoftoi Komitetin “Mbrojtja Kombëtare” të qytetit mbi

⁸⁴ *HHSIA.PA.A.* në *AIH*, Vj. 22-18-1839. Fjala e ministrit të Jashtëm grek në parlament.

⁸⁵ Basil Kondis, *Greece and Albania 1908-1914*, Thessaloniki: Institute for Balkan Studies, 1976, f. 23-124.

⁸⁶ Pirrhus J. Ruches, *Albania's captives*, Chicago: Argonaut, Inc., Publishers, 1965, f. 82.

⁸⁷ *AMAE* në *AIH*, F. 148, fl. 1512-1513, Raport i Konsullatës franceze të Janinës për Ministrinë e Jashtme, Janinë: 24 shkurt 1914.

⁸⁸ *HHSIA.PA.A.* në *AIH*, Vj. 24-7-756, Raport i atasheut të Austro-Hungarisë në Athinë për Ministrinë e Mbrojtjes, Athinë, 27 shkurt 1914.

udhëzimet e qeverisë greke⁸⁹. Prej konsullit francez në Korfuz deklarohet edhe ndërprerja e dërgimit të armëve⁹⁰.

Gjatë muajit shkurt vihet re edhe tërheqja nga qëndrimet e palëkundura të monarkut grek. Tashmë qëndrimi i deklaruar i tij shkonte në të njëjtën linjë me atë të qeverisë greke. Greqia do të respektonte me sinqeritet detyrimet e marrura përsipër⁹¹ dhe ai angazhohej se do të zbatonte me përpikëri vendimet e Evropës⁹².

Është e vështirë të konstatohet qëndrimin që realisht mbajti qeveria greke gjatë muajit shkurt të vitit 1914, në kushtet e dokumentacionit të paktë arkivor grek, të deklasifikuar dhe publikuar. Në ambientet e legatave të huaja në Athinë, kryeministri Venizellos shprehej se shikonte në lëvizje [nënkupto epirote, L.D] “vetëm orvatjen e popullsisë greke të Epirit për të siguruar një situatë nacionale të favorshme, por siç mendohet gjithmonë brenda shtetit shqiptar”⁹³. Më tej, në debatet parlamentare, kreu i qeverisë greke shtonte se “qeveria ime me politikën e saj ndaj çështjes epirote, nuk përkëdheli prirjet e opinionit. Ajo shpalli se autonomia e Epirit-hartë ishte e pamundur dhe një luftë për këtë qëllim do të përfundonte në katastrofë. Nëse i kam bërë ndonjë shërbim Greqisë, më i madhi është ai se kam zbatuar një politikë në kundërshtim me ndjenjat e opinionit”⁹⁴. Historianët grekë në botimet e tyre i gjejnë të sinqerta deklaratat e Venizellosit⁹⁵.

Përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha në Greqi dhe Shqipëri nuk ndanin të njëjtin mendim, në lidhje me sinqeritetin e deklaruar të qeverisë greke. I dërguari perandorak i Gjermanisë në Janinë besonte se gjatë muajit shkurt veprimet e armatosura në Shqipërinë e Jugut nuk ndihmoheshin

⁸⁹ *AIH*, A-IV-206, 32, Letër e Papullas-it për Komitetin “Mbrojtja Kombëtare” të Korçës, Korçë: 25 shkurt 1914.

⁹⁰ *AMAE* në *AIH*, F. 148, fl. 1370-1373, Raport i konsullit të Francës në Korfuz për kryeministrin dhe ministrin e Jashtëm, Dumerg, Korfuz: 8 shkurt 1914.

⁹¹ *HStA.PA.A.* në *AIH*, Vj. 24-7-756, Raport i atasheut ushtarak të Austro-Hungarisë në Athinë për Ministrinë e Jashtme, Athinë, 27 shkurt 1914.

⁹² *AMAE* në *AIH*, F. 148, fl. 1512-1513, Raport i Konsullatës franceze të Janinës për Ministrinë e Jashtme, Janinë: 24 shkurt 1914.

⁹³ *HStA.PA.A.* në *AIH*, Vj. 24-7-756, Raport i atasheut ushtarak të Austro-Hungarisë në Athinë për Ministrinë e Jashtme, Athinë, 27 shkurt 1914.

⁹⁴ *Po aty*, Vj. 22-18-1839. Fjala e kryeministrit grek në parlament.

⁹⁵ Shih, V. Kondis, *Greece and Albania....*; B. Papadakis, *Histoire diplomatique*; Petsalis-Diomidis, *Greece at the Peace Conference..*; P. Ruches, *Albania's Captives....*; PH. Philon, *The question of Northern Epirus....*, etj.

prej qeverisë greke duke besuar kështu në qëndrimin luajal të saj. Mendim të njëjtë shprehte edhe konsulli francez në Korfuz. Për të “qeveria greke nuk merr pjesë në asnjë mënyrë në rezistencën e popullsisë helenike të Epirit.... Ishte Zografosi, ai që përhap manifestime patriotike”⁹⁶. Ishte në të mirë të qeverisë greke që të qetësonte situatën në Shqipërinë e Jugut. Në të kundërt, “epirotët” do të jepeshin pas raprezalieve ndaj shqiptarëve, çka do t’i jepte shkas një pushtimi austro-italian, që sigurisht nuk i interesonte Greqisë⁹⁷. Në dallim nga dy diplomatët e mësipërm, atashu ushtarak i Austro-Hungarisë në Athinë besonte se qeverisë greke i pëlqente të luante me të dy anët. Karshi Fuqive të Mëdha ajo jepte garanci, fshehurazi ndofta i nxiste kryengritësit. Ai mendonte se Venizellosi ishte i plotfuqishëm në shtetin grek dhe kundër vullnetit të tij nuk mund të bëhej asnjë lëvizje greke e madhe ose e vogël, e përgjithshme ose lokale. Sipas tij, të gjitha vendimet merreshin në Athinë⁹⁸. Mendimet e diplomatit austro-hungarez përforcoheshin edhe nga anëtari britanik në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit, për të cilin, masat në zonën e pushtuar nuk ishin marrë pa dijeninë e autoriteteve greke të pushtimit dhe të atyre të Korfuzit. Zografosi gjatë shkurtit e kishte vizituar Korfuzin disa herë dhe kishte bërë takime me prefektin, Varatasi (Kostandinos Baratasis)⁹⁹.

Nuk ka dyshim se qeveria greke ndoqi ndaj Shqipërisë së Jugut një politikë sistematike aneksuese. Realisht edhe gjatë shkurtit të 1914, veprimet e armatosura të organizuara dhe ndihmuara prej saj, vazhduan. Qeveria greke kishte punuar për nxitjen e rezistencës, kishte furnizuar vazhdimisht me armë, kishte lejuar kontingjente andartësh të kalonin qetësisht kufirin. Pavarësisht se procesi i çarmatimit filloi, ai nuk arriti të shndërrohej në proces masiv dhe armët e mbledhura qenë të pakta. Ato u mblodhën kryesisht në zonën e Korçës. Nga ana tjetër me morinë e kërkesave dhe veçanërisht me rektifikimet e kërkuara në zonën e Gjirokastrës dhe të Korçës, në notën e 21 shkurtit 1913, qeveria greke

⁹⁶ AMAE në AIH, F. 148, fl. 1370-1373, Raport i konsullit të Francës në Korfuz për kryeministrin dhe ministrin e Jashtëm, Dumerg, Korfuz: 8 shkurt 1914.

⁹⁷ Po aty.

⁹⁸ HHSStA.PA.A. në AIH, Vj. 24-7-756, Raport i atashut ushtarak të Austro-Hungarisë në Athinë për Ministrinë e Jashtëm, Athinë, 27 shkurt 1914.

⁹⁹ AIH, A-VI-39, viti 1913-1914, fl. 121-122, Raport i anëtarit britanik në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit për ministrin e Jashtëm, Vlorë: 28 shkurt 1914.

vazhdoi t'i mbante peshë shpirtat e ndezur, duke ushqyer dhe forcuar shpresat e mbështetësve të bashkimit me Greqinë¹⁰⁰.

S u m m a r y

THE EFFORTS OF THE GREEK POLITICS FOR THE INVASION OF SOUTHERN ALBANIA: FROM DIPLOMACY TO ARMED ACTION (SEPTEMBER 1913 – FEBRUARY 1914)

In order to dominate the territories of southern Albania, the leaders of the Greek government developed an intense diplomatic activity within the international organizations and the chancelleries of the Great Powers. The meetings of the Greek officials manifested a continuous persistence on maintaining the occupied territories; on conditioning the issue of the Greek – Albanian borders with the issue of the Aegean islands; on changing the borders fixed by the London Conference and drafted by the Protocol of Florence; and lastly, on ensuring large guarantees for the pretended Greek population of southern Albania.

The intense diplomatic activity was amplified by the policy of the Greek administration on the occupied territories of southern Albania. The policy followed on the ground aimed to achieve what the diplomacy had not succeeded to do: the materialization of the detachment or the independence. The Greek military administration stimulated the enforcement of the Greek or pro – Greek element in southern Albania and sustained its reactions towards a union with Greece. This administration took measures to stop all expression of Albanian national consciousness. It played an essential role in the creation of the Saint Battalions and the organization of the armed resistance in southern Albania.

The Greek politics followed a systematic occupying policy regarding southern Albania. Even during February 1914, the Movement, actually, organized and sustained by them, continued. The Greek policy, generally worked on the Movement's encouragement, it provided arsenal and allowed contingents of rebels to easily pass the frontier. On the other hand, with the multitude of demands, especially the rectifications asked for the territories of Gjirokastra and Korça in its note of 21 February 1913, the Greek government continued to motivate and enforce the expectancies of those who supported the union with Greece.

¹⁰⁰ Edith Stickney, *Shqipëria e Jugut ose Epiri i Veriut në çështjet evropiane ndërkombëtare, 1912-1923*, Tiranë: "Koha", 1998, f.76.

